

TEMA NË PROZËN E MUSA RAMADANIT

Fitore XANI

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Musa Ramadani është autor i respektuar në letërsinë shqipe, i cili prej më se gjysmë shekulli është i pranishëm me krijimtarinë e tij te lexuesi dhe kritika letrare, e cila ka studiuar aspekte të ndryshme të krijimtarisë së tij. Arsye tjetër për këtë punim është veçantia dhe kompleksiteti i këtij opusi, si për nga rrëfimi ashtu edhe për nga temat dhe struktura e veprave të tij, ku trajtohen ide dhe tema të rëndësishme për kulturën dhe traditën shqiptare.

Musa Ramadani është një ndër shkrimtarët më të veçantë në letërsinë shqipe i cili “luan” në masë të madhe me kohën në krijimtarinë e tij në prozë. Ai rrëfen për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen dhe kapërcimi nga njëra kohë në tjetrën vjen krejt natyrshëm. Shkrimtari temat i merr nga realiteti për t’i trajtuar në një frymë të re ku imagjinaria dhe realiteti nuk kanë kufij, ndërsa fusha të ndryshme të artit, siç janë muzika, piktura ndërveprojnë natyrshëm në vepër.

Temat mbizotëruese në prozën e Ramadani janë vetmia, dashuria, vdekja, ndërsa lëvizja e pozitave të narratorit dhe rrëfimi brenda rrëfimit janë tiparet dalluese të prozës së tij.

Fjalë çelësa: prozë, narrator, temë, personazh, rrëfim.

Romani është ndër zhanret më të diskutuara dhe më të lëvruara të letërsisë. Teoricienë të shumë kanë theksuar se ndryshe nga zhanret tjera letrare, romani është një problematikë e vështirë për ta studiuar, sepse është vazhdimisht në rikrijim e zhvillim. Sipas Mikhail Bakhtin “*Romani*

konfrontohet me stihinë e së tashmes së pakryer, dhe për këtë arsye ky zhanër nuk mund të ngurtësohet. Romansieri synon gjithçka, që ende nuk ka përfunduar. Ai mund të shfaqet në fushën e strukturimit në çfarëdo poze të autorit, mund të prezantojë momente reale të jetës së tij, apo të bëjë aluzione në to, mund të ndërhyjë në bisedën e heronjve, mund të polemizojë haptazi me armiq të e vet letrar, etj.”¹

Letërsia synon të ndikojë te lexuesi me qëllim vetëdijesimin e tij dhe përsiatjen për tema të mëdha, siç janë jeta dhe vdekja, si kode të mëdha, apo tema të tjera të cilat kanë karakter lokal. Meqë nuk e kufizohet në gjatësi, më mirë se llojet tjera letrare, në roman, kjo përsiatje bëhet më lehtë e realizueshme. “*Romani do t’i parashohë faktet, të bëhet vizionar i tyre dhe të ndikojë në të ardhmen reale, të ardhmen e autorit dhe lexuesve. Romani shfaqet me probleme të reja, specifike, për të është gjë karakteristike revalorizimi. Qendra e përsiatjes dhe e arsyetimit të aktivitetit të kaluar bartet në të ardhmen.*”²

Musa Ramadani është ndër prozatorët i cili qysh me tregimet e para solli risi në letërsinë shqipe. Krijimtaria në prozë është një meditim i gjatë për jetën dhe vdekjen, dashurinë, dhimbjen, mallin dhe vetëmjaftueshmërinë. Krijimet e tij mund të lexohen veç e veç si tregime e romane, por vepra e tij mund të lexohet edhe si një tërësi, që duket se ka qenë synimi i autorit. Nga vepra në vepër ai sjell teknika të reja të rrëfimit, si dhe strukturë të re të veprës, e cila është e kalkuluar deri në imtësi, që lexuesin e “detyron” ta lexojë me një frymë. Personazhet e tij mund të jenë të çdo vendi dhe kohe - ata dashurojnë e vuajnë, janë në konflikt të vazhdueshëm me veten dhe ndonjëherë indiferentë deri në absurd ndaj rrethit ku jetojnë. Rrëfimi ndërmjet ëndrrës dhe zhgënjëdrës bën që lexuesi ta ketë vështirë ta kuptojë se ku fillon realiteti e ku imagjinata, ku kohët e ndryshme ndërveprojnë natyrshëm, ndërsa autori në rolin e narratorit është aty për ta shoqëruar lexuesin. Ramadani në shtjellimin e lëndës së tij romanore gjen prehje te miti, historia, psikologjia e parapsikologjia, që e bëjnë veprën e tij komplekse dhe të bukur njëkohësisht, ndërsa përmes figurave stilistike, siç janë metafora, paradoksi, satira, ironia, krahasimi etj., sjell një realitet të ri letrar ku ambienti shqiptar është lehtësisht i identifikueshëm. Gjuha e pasur e bën veprën e Ramadaniit intriguese për studiuesit të cilët do të enden nëpër kohë mitike dhe moderne së bashku me personazhet e tij.

¹ Mihail Bahtin, *Çështje të romanit*, Rilindja, Prishtinë, f. 47.

² Po aty, f. 51.

Sipas Eagleton veprat e letërsisë moderne janë vepra “të shkrueshme”(scriptible), ku shkrimtari i lë hapësirë lexuesit të bëhet pjesëmarrës në tekst dhe jo vetëm konsumues i saj. Sipas tij “*një vepër e moderne nuk zotëron një kuptim të përcaktuar, por është një strukturë e shumëllojshme, difuze dhe e pashtershme, një galaksi sinjifikantësh, njëthurje përfekte kodesh dhe fragmentesh të kodifikuara*”³.

Nisur nga kjo, romani “Ligatina” i Musa Ramadanit është një roman të cilin lexuesi mund ta lexojë sipas mënyrës së tij, duke marrë një rol ndërveprues. Romani nuk ka fillim “... nuk e njoh. Dhe nuk më njeh. Mbase ai mund të më njohë. As emrin nuk ia di. As ai – jam i bindur – nuk ma di. Megjithëse ai mund të ma dijë. Po kjo nuk do të thotë se edhe nuk mund ta njoh”⁴. Kështu, ai, që në fillim, lexuesin e njofton se edhe ai, sikurse personazhi, gjatë gjithë veprës do të përballet me të panjohurën. Vepra nuk ka një ide qendrore, por përgjatë rrëfimit shpalosen çështje që kanë të bëjnë me gjendjen shpirtërore dhe psikike të njeriut dhe të gjitha ngjarjet që zhvillohen kanë për qëllim pasqyrimin e saj me tërë kompleksitetin e saj, ku dilemat, humbja, frika, mungesat, ndjenja e mospërkatësisë në asnjë vend bëjnë që rrugëtimi përgjatë veprës të jetë kompleks, por edhe intrigues. Çështjet në roman nuk trajtohen nga perspektiva shoqërore, por si përjetim i individit, ku ambienti i jashtëm ka pak ndikim - më tepër janë nxitje për meditim.

Në romanin “Zezona”, përgjatë rrëfimit të vendosur në realitetin shqiptar, autori rrëfen për aksionin e mbledhjes së armëve të shqiptarëve nga pushteti serb dhe për torturat që pësonin shqiptarët kur nuk kishin çka të dorëzonin: “*Po prej kujt po lypin armë?- Prej të gjithëve. A është shqiptar, mendojnë që secili ka armë në shtëpi. Me rend po i thërrasin, e po i marrin në pyetje dhe ...*”⁵, dhe shpërnguljet që ndodhin si pasojë e kësaj. Kjo i shërben autorit të evokojë një periudhë të kaluar ku shqiptarët detyroheshin të shpërnguleheshin në Turqi.

Ndërkaq, te “Vrapuesja e Prizrenit” Musa Ramadani solli një teknikë të re të rrëfimit në romanin shqip, duke përdorur rrëfimin brenda rrëfimit. Romani hapet me rrëfimtarin i cili tregon se kush është dhe rrugëtimin e tij ndër shekuj, rrugëtim ky në kërkim të vajzës që e kishte takuar vetëm një herë. Përmes rrëfimit të tij në kuptojmë për ndjenjat, frikën dhe vetminë e tij, që është karakteristikë e personazhit, por edhe e

³ Terry Eagleton, *Hyrje në teorinë e letërsisë*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2005, f. 152.

⁴ Musa Ramadani, *Ligatina*, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 9.

⁵ Musa Ramadani, *Zezona*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f.27.

njeriut modern i cili vazhdimisht është në kërkim të vetvetes, dikujt tjetër apo diçkaje të papërcaktuar.

“... Jam unë Isa, Jezui. K-ja i Kosovës, më quajnë Veronez.

Një herë, tek më shpinin për në Qabe, në Kalvar, në Prishtinë, udhës sime më të gjatë në jetë, pas shtegimit të pambarim, u ndalëm për të pushuar një çikë në Therandë, në qytetin përnën Sharr, në Pëzeren. Bënte vapë, këmbët më koloviteshin, unë ecja marramenthi. Piva ujë mali, u mora erë trëndafilave të kuq, hëngra bukë e djathë, përtypa me të vështirë një mollë, e pastaj u dëgjua urdhri: vemi...! atë çast, para syve të mi të lodhur po të këndellur paksa, se nga mbiu befas një vash me trup të gjatë, me pamje prej hebreje: fytyrë esmere, hundë kthyer përprjetë, në majë, fort symadhe, e gjallë si njala. Nxori një shami nga gjiri për të ma fshirë fytyrën e djersitur. Nxori një shami nga gjiri për të ma fshirë fytyrën e djersitur... Sahora u përhumba para bukurisë së saj..., Vasha më humbi sakaq, ndoshta më shpejtë seç e gjeta aty”⁶

Për komunikimin modern, të cilin e mëton Ramadani, Rexhep M. Shala thotë: *“Me sinkretizëm përpiqet që ta individualizojë realitetin dhe ta objektivizojë fantazinë përpiqet ta krijojë realitetin fantastik (në kuptimin: realitet artistik) dhe fantastikën reale (në kuptimin: fantazi e mundshme). Tenton ta shndërroje artin në jetë dhe jetën në artë (realitetin- në metafizikë dhe metafizikën- në realitet, si një nevojë neurotike për t’i barazuar dimensionet e ekzistencës, për ta tejkaluar determinizmin tredimensional të ekzistencës). Me këtë formën e ofron si përmbajtje dhe përmbajtjen e ofron si formë, duke tejkaluar ideologjizmin e tyre si dhe formalizmin formal.”⁷*

Kështu, Ramadani është një ndër shkrimtarët shqiptarë që krijojnë një realitet letrar ku fantastikja dhe realja ndërveprojnë natyrshëm ndërmjet vete dhe ku lexuesi vazhdimisht përballet me dilemën nëse një ngjarje ka ndodhur vërtet apo është thjesht fiksjon.

“Antiprocioni”, është vetëm njëri nga romanet ku fantastikja dhe realja ndërveprojnë ngushtësisht njëra me tjetrën. Ramadani del si shkrimtar me njohuri të shumta nga fusha të ndryshme të artit dhe njohës i mirë i miteve, të cilat i ka shfrytëzuar si lëndë për të krijuar një realitet letrar. Në veprën e tij, lexuesi përballet vazhdimisht me ngjarje e perso-

⁶ Musa Ramadani, *Vrapuesja e Prizrenit*, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 9.

⁷ Rexhep M. Shala, *Theory, komunikimi modern*, Papyrus, Prishtinë, 2001, f. 102.

nazhe mitike e historike, ndërsa është autori ai i cili e udhëheq nëpër këtë realitet metafizik letrar.

“Posa u ktheva nga Stambolli, më arrestoi Veziri i madh dhe më hodhi në burg në kështjellën Gelibolu, ku ma lexuan fermanin: ose të vdisja si shehit ose të kaloja publikisht në islam, duke ma propozuar vendin e shërbëtorit të Oborrit mbretëror me një rrogë të majme! Unë zgjodha këtë të dytën, edhe pse pas një kohe më syrgjynosën në Kalanë e Ulqinit. E dija se një pjesë e hebrenjve ende më besonin, po edhe më gjykonin veprën time...

Pikërisht këtu, ëndrra zu të më daravitej, e gjumi të më shprishej, ethet s’më kishin lëshuar krejtësisht, ngase dëgjoja cingërimën po s’mund ta përcaktoja se ku gjendej telefoni im.”⁸

Në veprat “Fluroma”, “Satana ma vodhi gurinë e urtisë” dhe “INAMOR:55”, autori mediton për jetën, vdekjen, dashurinë, por edhe për jetën pas vdekjes, ku miti dhe bashkëkohësia bashkëjetojnë.

Duke interpretuar përmbledhjet me tregime të fazës së parë krijuese të Ramadanit, Nysret Krasniqi thekson: *“Ajo që mund të themi për prozën tregimtare të Musa Ramadanit të kësaj faze krijuese, është se ky autor nuk lidhet për temat e mëdha, qofshin ato ideologjike apo nacionale, por në laboratorin e mundimshëm krijues të tij rrok gjendjet e përditshmërisë dhe të preokupimeve të individit, qofshin ato mendimtarë, qofshin ato të krizave krijimtare, qofshin të krizave të veprimit duke ndërtuar kështu një poetikë të veçantë të rrëfimit në letërsinë e Kosovës, pretendimi i së cilës del të jetë inovacion i formës, loja me paradokset gjuhësore e në këtë udhë edhe me tërë strukturën tradicionale të rrëfimit, por edhe theksimi i temës së individit në letërsi”⁹.*

Krijimtaria e Ramadanit është e pasur me ide dhe tema, prandaj kërkon një lexues të kultivuar, një lexues që e njeh jo vetëm letërsinë, por edhe fusha të tjera të dijes, si mitologjia, historia, psikologjia, dukuritë parapsikologjike, feja e ritet fetare. Në prozën e Ramadanit temat trajtohen në raport me individin dhe ndjesitë e tij, duke sjellë kështu një rrëfim shumëdimensional të jetës nëpër kohë të ndryshme. Në veprën e tij, asgjë nuk është absolute dhe e përhershme, por e përkohshme, prandaj njeriu vazhdimisht përballet me të panjohura dhe me situata që duhet t’i përballojë në vetmi.

⁸ Musa Ramadani, *Antiprocioni*, Buzuku, Prishtinë, 2015, f. 84.

⁹ Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99-AIKD, Prishtinë, 2016, f. 142.

Vetmia si temë

Tema e vetmisë trajtohet që në përmbledhjen me tregime “Fluro-ma”, ku personazhet meditojnë për jetën e vdekjen në vetmi - madje edhe kur janë të shoqëruar nga të tjerët ndihen të vetmuar. Në tregimet “Apati”, Funerali. Dy plus tre”, “Amaneti (I Plakut vetmitar)”, “Lëmoshëtarët”, autori sjell personazhe të cilët, pavarësisht se jetojnë mes njerëzish qofshin familjar apo fqinj, janë të vetmuar.

“Unë jam në këtë dhomë. E dhoma nuk është imja. Megjithëse unë jam brenda. E brenda janë edhe katër mure, duke mos llogaritur tavanin. Dhe asgjë tjetër pos asaj se është e përmbushur me shprazti. E vetmja mbretëri që ka ngrehur fron konsiderohet vetmia dhe heshtja, atëherë kur fuqitë i bëjnë një.”¹⁰

Temën e vetmisë Musa Ramadani e trajton edhe në përmbledhjen me tregime “Satana ma vodhi gjumin e urtisë”, ku paraqet jetën e vetmuar të njerëzve edhe kur ata ndërveprojnë mes vete, ndërsa te “Robinsoni midis njerëzve” tregon për fatin e njeriut, i cili edhe kur është i rrethuar nga njerëz ndihet i vetmuar, prandaj është i detyruar të mësohet me vetminë.

“Pra, as ia kish pas dëgjuar emrin ndoshta Robinsonit. Po me siguri e ndjente veten si ai. E përjetonte fatin e tij. Deri atë ditë kur ta mbulonte varri. Mu në qytet. Midis njerëzve, në botën e civilizuar. I kish dënuar ky bashkëqytetarët apo ata e kishin dënuar këtë? Në krye të muajit, Moni kish pësuar edhe një shndërrim të ri.”¹¹

Vetmia del si temë edhe te “INAMOR:55”, në tregimin “Si e kri-ova Golemin”, ku shkrintari, përveç që tregon për vetminë e tij, thotë se njeriut i duhet dikush që t’ia mbushë këtë boshllëk - i mjafton një krijim i tij.

“Vite të tëra përsiata për Golemin. Se si ta krijoja. Ta ngjallja. T’i jepja frymë. Isha gjithnjë i vetmuar, mendoja i vetmuar dhe e ndjeja veten të vetmuar. Kisha nevojë të madhe për dikë. Një shërbëtor besnik. Ndhimë e fortë. Për një bocë të patrajtë argjile. Një embrion. Njeri. Kjo do të ish preventivë në rast të përndjekjes sonë.”¹²

¹⁰ Musa Ramadani, *Fluro-ma*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 10.

¹¹ Musa Ramadani, *Satana ma vodhi gurin e urtisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2007, f. 82.

¹² Musa Ramadani, *INAMOR:55*, Buzuku, Prishtinë 2000, f. 48.

Tema e vetmisë shkrimtarit i jep mundësi që të shpalosë para lexuesit skutat më të thella të botës së brendshme të individit. Ramadanit e trajton vetminë e individit në një ambient ku të gjithë ndihen të vetmuar, pavarësisht marrëdhënieve që kanë me të tjerët përreth. Ata jetojnë me vetminë e tyre, pa u lodhur për rrethin.

Dashuria si temë

Dashuria është një ndër temat universale dhe të gjithëkohshme, e cila, ashtu si edhe në krijimtarinë letrare të autorëve të ndryshëm përgjatë historisë së letërsisë botërore, ka zënë vend edhe në letërsinë shqipe. Tema e dashurisë, së bashku me atë të vdekjes dhe të vetmisë, është ndër temat qendrore në gjithë krijimtarinë e Musa Ramadanit. Dashuria për Ramadanin është gjakim që vjen nga lashtësia, është nevojë për të mbushur shpirtin njerëzor. Ajo, sidoqoftë, mbetet e parealizuar, pa një fund të lumtur.

Tema e dashurisë na del që në tregimet e para të Ramadanit, për t'u sendërtuar pastaj edhe në romane të tjera, të cilën shkrimtari e quan “*së-mundje, në kajde të melankolisë..., përcaktimi i objektit të dashurisë është një mënyrë e të shëruarit...zbulimi bëhet përmes plusit tek personi...*”¹³

Rrëfimi i Ramadanit ndërmjet ëndrrës e zhgjëndrrës bën që këto personazhe të jetojnë dashurinë e tyre në vetmi dhe gjithnjë të jenë në kërkim të saj. Ai gjakon të tregojë për një dashuri, e cila sa është e bukur kur realizohet, aq i bën njerëzit fatkëqinj kur nuk kthehet, ndërsa është edhe egoiste teksa dëshiron ta zotërojë plotësisht personin tjetër.

*“Po prapë, s’kisha fuqi, jeta është e ëmbël: Abidi me siguri do të jetë vetëm i imi. Krejt i imi, këmbë e krye. Askush s’do të mundet të ma rrëmbejë. Gjithnjë do të jetë imi. Kurrë s’do të më braktisë. Ai nuk do t’i shikojë të tjerat. Edhe po të donte, nuk do të kishte mundësi të shohë femrat e tjera në rrugë. Pra – nuk do të mundej as të dashurohet në to. Të vrapojë pas tyre...Jo, jo, jo, Kjo është lumturia ime!”*¹⁴

Personazhet e dashurisë na vijnë që nga antikiteti. Ata dashurojnë me një shikim, me një prekje, por dashuria e tyre nuk realizohet, ajo nuk u kthehet atyre që e japin.

¹³ Musa Ramadani, *Satana ma vodhi gurin e urtisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2007, f. 15.

¹⁴ Musa Ramadani, *Fluroma*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 117.

Romani “Vrapuesja e Prizrenit” është një himn për dashurinë, ku personazhet enden natyrshëm nga një kohë në tjetrën; është një ecje-ikje në një qytet të vjetër për të shpalosur historinë, kulturën, por edhe bukurinë e qytetit të Prizrenit. “Musa Ramadani kapet për tragjizmin e kërkimit, për Veronezin e Veronikën në ambientin shqiptar, apo për Romeon e Xhulietën e Prizrenit, me insistimin permanent se botën dhe ekzistencën e saj e mban dashuria, e cila në kuadër të jetës së saj riaktualizon antikën, klasiken e modernen, si fuzionim mitik arkeologjik, historik e bashkëkohor i vazhdimsisë ilire-shqiptare në toposin e qytetit muze të Prizrenit”¹⁵, thotë Krasniqi.

Tema e dashurisë në krijimtarinë e Ramadani është multidimensionale, ajo është dashuri për vendin, dheun, e atdheun, ku vuajtja dhe mungesa e përcjellin në çdo hap.

Vdekja si temë

Tema e vdekjes, herë si heroike e herë si e natyrshme, është e pranishme që në letërsinë antike. Ramadani është ndër shkrimtarët shqiptarë të cilin tema e vdekjes e intrigon në tërësinë e saj, që nga frika dhe dyshimet për të e deri te ceremonitë mortore.

Realiteti i veprës letrare të Ramadani është realiteti shqiptar nëpër kohë dhe hapësira të ndryshme, prandaj edhe kjo temë trajtohet në këtë frymë, duke sjellë edhe kulturën dhe zakonet shqiptare, si dhe raportin e njeriut me vdekjen, që ai e konsideron guxim, pasi frika për të panjohurën është ajo e cila i ndalon ata ta mendojnë. Në krijimtarinë e tij shkrimtari shkruan për njeriun dhe veset e tij, e studiuesi Nysret Krasniqi thekson se “*Musa Ramadani nëpërmjet të vdekjes, kthehet te tema e tij obsesionuese e mëkatit dhe hipokrizisë njerëzore.*”¹⁶

Në përmbledhjet me tregime “Fluroma”, “Satana ma vodhi gurin e urtisë”, “INAMOR:55”, vdekja është e pranishme si një e panjohur që vjen kur nuk e pret dhe njeriu është plotësisht i pafuqishëm për ta ndaluar atë, ndërsa edhe çasti i fundit është i ndryshëm për secilin, teksa ajo që vjen pas vdekjes është enigmë për të cilën flasin të gjithë, pa ditur se si është bota përtej.

¹⁵ Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99-AIKD, Prishtinë, 2016, f. 524.

¹⁶ Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99-AIKD, Prishtinë, 2016, f. 141.

*“Kush e ka kuptuar plotësisht jetën, nuk i frikësohet vdekjes. Frika nga vdekja është vetëm rezultat i një jete të papërmbushur...”*¹⁷

Në romanin “Romani pa kornizë”, përveç përsiatjes së vazhdueshëm për vdekjen, shkrimtari sjell edhe zakonet dhe ceremoninë e varrimit, ku tregon edhe diferencimin që njerëzit e gjallë ua bëjnë të vdekurve.

*“Tani arkivolin e përcillnin sall gjashtë vetë: katër që e bartnin, njëri, ai që me siguri do të duhej të jetë më i afërmi i të ndjerit e i rrinte te këmbët, dhe një tjetër përbri tij, të cilit i kishte rënë hise të ndërrojë herë njërin e herë tjetrin prej tyre, të cilët bënë punën kryesore, dhe prej të cilëve pritej më së shumti në rrugën deri te varrezat... Vetëm një plak i bërë dyfish dhe i kthyer mu si kërryla e tij, e cila ia mbante peshën e të shtatëdhjetave, i ngashëryer aq sa i pikën edhe lotët, me keqardhje tha: Paska qenë derë e fikur..., se të ishte ndonjë i njohur apo i pasur, rruga se kishte zënë xhematin”.*¹⁸

Vdekja pavarësisht se jo në plan të parë, trajtohet edhe të “Ligatina”, ku shkrimtari merr motivin e vdekjes për të trajtuar temën e hakmarrjes dhe atë të shpërnguljes. Vdekja në këtë roman është e pranishme që në fillim, kur Abaz Guri fillon rrugëtimin e tij në kërkim të vrasësit të babait. Shkrimtari tregon për nderimin e madh që i bëhet vdekjes dhe të vdekurit, për vdekjen që njeriun e përcjell që nga lindja, qoftë si humbje e personave të dashur, qoftë përmes varreve si dëshmi.

*“Sido që të jetë, të vdekurve u shprehnin nderimin gati të gjithë, pa marrë parasysh fenë e kombësinë”.*¹⁹

Musa Ramadani është një ndër shkrimtarët të cilët pasionin për letërsinë e shpalosin më së miri përmes ndërthurjes së temave si jeta dhe vdekja, të cilat në krijimtarinë e tyre bashkëjetojnë.

Personazhet në prozën e Musa Ramadani

Në letërsinë shqipe shkrimtarët kanë krijuar personazhe që mbahen mend. Musa Ramadani është ndër shkrimtarët që shquhet edhe për personazhet që ka ndërtuar. kryepersonazhet e tij janë bartës të rrëfimit dhe në funksion të ngjarjes, ndërsa personazhet episodike janë në fun-

¹⁷ Musa Ramadani, *INAMOR*:55, Buzuku, Prishtinë, 2000, f. 70.

¹⁸ Musa Ramadani, *Romani pa kornizë*, Bota e re, Prishtinë, 1975, f. 49-50.

¹⁹ Musa Ramadani, *Ligatina*, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 142.

ksion të atyre kryesorë. Ata, shumicën e rasteve nuk prezantohen me emër e mbiemër të plotë, por njihen nga profesioni që ushtrojnë, që ishte karakteristikë e letërsisë së shekullit XX.

Personazhet e Ramadanit e shfaqin veten e tyre në raport me të tjerët, ndërsa lexuesi, përmes veprimeve dhe ndjenjave të tyre, kupton më shumë rreth tyre dhe realitetit letrar. Ato personazhe, sa janë universale, po aq janë edhe lokale.

Sipas Rexhep M. Shalës, “*Proza me natyrën e vet të hapur në dinamikën e interaksionit zhanror e natyralizoi me sukses edhe dialogjicitetin funksional duke ofruar një përvojë dhe një tip të prozës psiko-sociale që shquhet me identitetin e karaktereve dhe frustrimin aktual në kontekstin psiko-social e socio-politik duke ofruar dramën e individit, grupit dhe kolektivitetit.*”²⁰

Në përmbledhjen “Fluroma”, personazhet që rrëfejnë nuk kanë tipare të jashtme, ndërsa është lexuesi ai i cili, duke vënë në punë imagjinatën, mund t’ua japë fytyrën dhe trupin që dëshiron. Ata nuk kanë emër. Nga rrëfimi i tyre e kuptojmë se personazhi është mashkull, ndërsa përmes monologut pa zë ne i identifikojmë ndjenjat, frikën, mendimet e dëshirat. Ata përshkruajnë ambientin që i rrethon.

“*Këtu fillon gëzimi dhe pikëllimi im, këtu. Në këtë dhomë të mbramë të botës ku heshtja këndon e vetmia vajton si fëmijë... këtu është gjunjëzuar jeta ime, E unë nuk di çfarë do të thotë: jetesa. Unë ndjej dhe jetoj vetëm brenda këtyre dy fjalëve: ide dhe zë! Po, vetëm kur këndoj dhe përsias e di përnjëmend se jetoj.*”²¹

Përmes këtij fragmenti kuptohen shumë gjëra për personazhin, si vendi ku ndodhet, dëshira e tij për të medituar, si dhe preokupimet e tij. Përmes diskursit narrativ të personazhit kuptojmë se nëpër çfarë kalon personazhi.

Sipas David Lodge, “... mënyra më e thjeshtë që një personazh të prezantohet në letërsi është të jepen përshkrime psikike dhe të dhëna biografike”,²² teknikë të cilën Ramadani e përdor në disa prej tregimeve të tij. Ai ofron të dhëna për personazhet, por i lë anonim. Ata i njohim vetëm si Ai apo Ajo dhe ata vetë rrëfejnë, pra ngjarja tregohet sipas perspektivës së Atij apo Asaj.

²⁰ Rexhep M. Shala, *METATEZA, Teoria dhe praksi letrar*, Neokultura, Prishtinë, 2014.

²¹ Musa Ramadani, *Fluroma*, Rilindja, Prishtinë, 1975, q. 14.

²² David Lodge, *The Art of Fiction*, Viking Pengiun, New York, 1992, f. 67.

“Megjithëse veçsa kam kaluar dekadën e pestë të moshës, ende jam beqar. Kisha takim me vajzën afro dy dekada më të re se unë. Mirëpo simpatike dhe gjithnjë sharmante. U rrova para pasqyrës sipër lavamanit në banjo, u parfymosa pak, kreha flokët dhe vajta te kafe “D’ora”. Isha i saktë sall në takimet me vajza...

Pranë tavolinës-sofër, me dy mbulesa të bardha flokë të përdredhur a la minival, një parfum francez agresiv dhe thonj tejet të gjatë. Pinim kafe espresso, coca cola dhe cigare nga importi. Nuk llafosnim. Hesh-turimë. Vetëm shikoheshim. Unë vështroja sytë e saj të mëdhenj, hundën picigjate kthyer me majë dhe buzët mishtake.”²³

Përshkrime si ky i gjejmë rrallë në krijimtarinë në prozë të Ramadanit, pasi shkrimtari nuk dëshiron të ndërtojë karaktere lehtë të identifikueshme për lexuesin.

Personazhet në prozën e shkrimtarit janë plotësisht në funksion të temës që trajton - ato janë bartëse të rrëfimit, përmes të cilëve autori jep perspektivën e tij për idetë e tij.

Personazhet janë të moshave të ndryshme, ndërsa personazhi i Plakut është i pranishëm gjithandej në këtë krijimtarë, me qëllim të nxjerrjes së përvojës së tij jetësore.

“Turravrap vjetët kaluan. Pleqëria më zgërdhihej si vdekja, çdo ditë. Gati pahetueshëm. Shtatëdhjetë e sa herë prita ndërrimin e stinëve. Dhe u pajtova me fatin tim. Bëhen pesë vjet qëkur gjendem në Shtëpinë e Pleqve, në këtë qytet. Po të mos ishte dëshpërimi, s’do të dorëzohesh kaq shpejt para jetës. Po mos të ishte rakia, sa kam fituar, sot do të mund të ndërtoja një pallat, në mos më të madh, atëbotë sa kjo godinë e Gjyqit po.”²⁴

Ndryshe nga personazhet e tregimeve që janë më vetmitarë dhe kanë kohë të mjaftueshme për të medituar për jetë e vdekjen, dashurinë e fenomene të tjera metafizike, në romanet e Ramadanit, personazhet si bartës të rrëfimit janë ata që pasqyrojnë të kaluarën dhe të tashmen. Në romanin “Zezona” ka numër të madh të personazheve që identifikohen përmes punës që bëjnë, e rrallë si personazhe me emër e mbiemër. Duke qenë se problemi i armëve ishte shoqëror, personazhet mund të jenë çdonjëri nga shqiptarët që ka jetuar në Kosovë në atë kohë. Ata janë dëshmia e gjallë e asaj që ka kaluar populli shqiptar.

²³ Musa Ramadani, “INAMOR”, Buzuku, Prishtinë, 2000, f. 45.

²⁴ Musa Ramadani, *Romani pa kornizë*, Bota e Re, Prishtinë, 1975, f. 80.

*“Po them de, kësi zullumi s’mbaj mend.
Të tetëdhjetat i rrotullova, e s’ka bërë vaki kështu.
Tërë fshati të prishet dajak- kjo s’është mahi!!*

E kam pritur kohën e Serbisë së Parë, të Bullgarit të Parë (po asgjë s’ishite i Pari; i Dyti na doli dredhë), e të Austrianit, a po merr vesh, a po ngo knej, e kësi nami s’na ka gjete.

Kështu, rrahur kush s’na ka-e!”²⁵

Personazhet e këtij romani janë të llojllojshëm, modelimi i tyre është bërë me qëllimin që tema të trajtohet nga të gjitha perspektivat. Kështu, kemi personazhe si Fshatari, Ardhasaku, Korrierin e shkollës, Plakun, ish-Këshilltarin, Hoxhën, Mësuesin, Fëmijën, Plakën, Nusen, Popin, Policin etj., përvojat, frikën e ndjenjat e tjera të të cilëve i tregon shkrintari. Në anën tjetër të rrëfimit janë personazhe të cilat përmes veprimeve të tyre identifikohen si të huaj, torturues dhe të pamëshirshëm.

Personazhet femra në këtë roman janë të pakta dhe episodike dhe kryesisht shërbejnë për të paraqitur vështirësitë nëpër të cilat kalojnë burrat e fshatit. Kështu, karakteret e këtij romani janë plotësisht në funksion të rrëfimit dhe temës që trajtohet, ata janë dëshmi e një kohe të vështirë nëpër të cilën ka kaluar populli ynë, kurse mosidentifikimi i tyre dhe i tipareve të tyre ka për qëllim universalizimin e tyre.

Ndryshe nga romani “Zezona”, ku shumica e personazheve identifikohen në bazë të profesionit, personazhet në romanin “Vrapuesja e Prizrenit” janë të identifikueshme. Në këtë roman ka personazhe që janë komplementare varësisht prej kohës kur jetojnë: Veronezi/Veronika, Vrapuesi i Epirit/ Vrapuesja e Epirit dhe Abdyl Takia/Alixhanja, që janë në qendër të rrëfimit. Aty ka edhe personazhe episodike që shërbejnë për të përforcuar idetë që përcjell autori.

Linja e parë e rrëfimit në këtë roman ndërtohet përmes personazheve të Veronezit dhe Veronikës, për të cilët autori tregon se kush janë pa ndonjë përshkrim të thellë, ndërsa për cilësitë e tyre, qofshin ato fizike apo psikike, mësojmë më shumë prej dialogëve që ata zhvillojnë ndërmjet tyre.

“Mbase nga shkakun se nuk duam të lirohemi, lirohemi”, tha Verona.

Unë do të thosha; shtoi Veroni, “pse gjakojmë aq shumë lirinë”.

²⁵ Musa Ramadani, *Zezona*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 70.

“Liri gëzon edhe gaforrja”, thotë Migjeni, “por gjakojmë aq shumë lirinë”.

“Liri absolute s’ka, parafrazoi mendimin e një filozofi Verona, “liria do pushtuar dalëngadalë, pareshtur, gjithmonë”.

“Arti jeton prej kufizimeve, e vdes prej lirive, ka thënë Anre Zhid, mirëpo, sikur të isha unë vetë art, përvijoi tek ai, më me ëndje do të vdisja në liri sesa të jetoja në kufizime të vazhdueshme...”, përplotësoi Veroni.

Ne jetojmë me ngarkesa të përditshmërisë, të historisë, të arkeologjisë...e kushedi se edhe çfarë të tjera!, vargoi me nervozitëm Verona.

“rrethi i ngushtë ta topit mendjen, ta mjegullon vështrimin, ta rrjeton zemrën, këtë unë e hetoj nga moslëvizja e vendnumërimi”, tha Veroni.”²⁶

Interaktiviteti i vazhdueshëm i Veronikës me Veronezin na shpalos edhe cilësitë e saj, por, ndryshe prej Veronezit, për vajzën kemi edhe të dhëna fizike përveç atyre psikike dhe shpirtërore.

Kështu ne e kuptojmë se Veronika është me e re se Veronezi, se ka ten të errët të lëkurës, gojë të vogël, sy të dalë jashtë, trup të hajthshëm, hundë me majë përpjetë, i pëlqen të udhëtojë, ka njohuri nga fusha të ndryshme, jeton në Prizren, është intelegjente, e pavarur dhe e gatshme të hyjë në diskutime të gjata për tema të ndryshme të artit, si dhe është e obsesionuar me skulpturën.

Përmes rrëfimit autori krijon dy karaktere fatkeqe, secili sipas mënyrës së vet: Veronezi është fatkeq sepse Veronika nuk i përgjigjet dashurisë së tij, ndërsa Veronika fatkeqe sepse nga frika e refuzon Veronezin.

Karakteret fatkeqe janë edhe Alixhanja dhe Abdyl Takia, të cilët vijnë nga një kohë e largët dhe të cilëve jeta u kalon në kërkim të dashurisë. Ajo është një vajzë e bukur nga një familje e pasur, ndërsa Abdyl Takia një djalë i varfër. Ata takohen vetëm një herë, mirëpo e tërë jeta u kalon në kërkim të njërit-tjetrit.

“Jam e bindur se dashurinë, mund ta kërkon afër dhe larg, natën dhe ditën, në tokë e në qiell, e ndoshta s’mund ta gjesh kurrë. Ajo vjen vetë, shfaqet papritur, shkëlqen si një margaritar që t’i merr sytë njëherë e përgjithmonë. Nuk dihet se ku, kur dhe si. E ka yllin e vet, shenjën e vet, fatin e vet. Po se përqafove menjëherë, flakën e saj që të ndriçon e të

²⁶ Musa Ramadani, *Vrapuesja e Prizrenit*, Faik Konica, Prishtinë, 2005, f. 119.

djeg, shndërrohet pastaj në shkumb e në hi, në dhembje e në vuajtje, në tym e në hiç.”²⁷

Në romanin “Vrapuesja e Prizrenit” kemi disa personazhe të cilat dalin në plan të parë, ndërsa në romanin “Ligatina” kemi një karakter primar, ndërsa të gjithë të tjerët janë në funksion të atij karakteri. Abas Guri është bartës i rrëfimit dhe i gjithë rrëfimi shpaloset përmes perspektivës së tij. Sikurse edhe për personazhet e tjera në krijimtarinë e Ramadanit, lexuesi nuk di asgjë fillimisht për personazhet e tij, por së pari shpaloset qëllimi përfundimtar e pastaj të gjitha karakteristikat e karaktereve prozaike dhe ngjarjes që zhvillohet në vepër, bartës të së cilës janë personazhet, në këtë rast është Abas Guri, qëllimi i të cilit është të vrasë vrasësin e të atit, për të cilin lexuesi, pavarësisht zhvillimit të rrëfimit, nuk merr asnjë informacion, por që hija e tij e përcjell Gurin prej fillimit deri në fund.

Krijimtaria e Musa Ramadanit është autentike që prej temave që trajton, rrëfimit, karaktereve, si dhe mënyrës se si ajo komunikon me lexuesin. Kjo krijimtari para së gjithash kërkon një lexues të kultivuar për ta kuptuar në plotësinë e saj.

Përfundime

Nga studimi i veprave në prozë të Musa Ramadanit mund të përfundohet se krijimtaria letrare e këtij autori është komplekse si në ndërtim strukturor, ashtu edhe në ide. Nga ana tematike është e pasur me tema të cilat trajtohen nga perspektiva e personazheve, duke sjellë kështu një tablo komplekse të temave, si dashuria, jeta, vdekja, vetmia, hakmarrja, shpërngulja etj., tema këto që zënë fill në tregime e pastaj në romane marrin dimensione të tjera dhe trajtohen gjerësisht. Narracioni të Ramadanit është ndër aspektet më të rëndësishme dhe komplekse që zhvillohet nga perspektiva e narratorit, i cili herë flet në vetën e parë e herë në të tretën, krahas narratorit omnishent.

Te ky shkrimtar, personazhet janë bartës të rrëfimit dhe në funksion të ngjarjes dhe kohës që shkrimtari trajton në veprën e tij, ndërsa karakteret episodike janë në funksion të atyre kryesore. Pra, roli i tyre është vetëm të vënë në pah karakteret kryesore. Personazhet në krijimtarinë e Ramadanit në shumicën e rasteve nuk prezantohen me emër e mbiemër të

²⁷ Po aty, f. 123.

plotë, por ata i njohim nga profesioni që ushtrojnë, gjë që ishte karakteristike e letërsisë së shekulli XX.

Shkrimtari në veprën e tij krijon një realitet fiksional të bazuar në realitetin shqiptar, dhe kjo vërehet që nga tema, personazhi, vendi, hapësira, koha për të cilën shkruan, si dhe elementet autobiografike të cilat Ramadani nuk i kursen në veprën e tij, e të cilat dalin si dromca nga vepra në vepër për të na treguar si ka qenë fëmijëria, rinia, martesat, shkrimtarët e tij të preferuar, muzika, piktura e madje edhe gjendja e tij shëndetësore. Duke i ditur këto elemente autobiografike, lexuesi bëhet i afërt me autorin dhe fiton jo vetëm simpatinë për të, por edhe mrekuullohet me informacionin e shumtë që ka ky autor.

THEMES IN MUSA RAMADANIT'S FICTION

Summary

From the study of the prosaic opus works of Musa Ramadani it can be concluded that the literary creativity of this author is complex both in structural construction and in ideas. Thematically, it is rich in topics that are treated from the perspective of the characters, thus bringing a complex picture of topics such as love, life, death, loneliness, revenge, displacement, etc. These topics that begin in short stories and then in novels take other dimensions and are extensively addressed. Ramadani's narration is one of the most important and complex aspects developed from the perspective of the narrator who sometimes speaks in the first person and sometimes in the third, alongside the omniscient narrator.

In his opus, the characters are the bearers of the narrative and in function of the event and the time the writer places the events, while the episodic characters are in function of the main ones, so their role is only to highlight the main characters. Characters in Ramadani's opus in the most of the cases are not introduced by full name and surname, but we know them by their occupation, which was one of the features of twentieth century literature.

The writer in his work creates a fictional reality based on Albanian reality, and this can be seen from the themes, characters, places, space and time he writes about and the autobiographical elements that Ramadani does not spare in his work, which emerge as fragments from work to

work to show us what his childhood, youth, marriage, his favorite writers, music, paintings and even his state of health were like. Knowing these autobiographical elements the reader becomes close to the author gaining not only sympathy for him, but also being amazed by the abundant information that this author has.

Literatura

Bahtin, Mihail, *Çështje të romanit*, Rilindja, Prishtinë, 1980.

Eagleton Terry, *Hyrje në teorinë e letërsisë*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2005.

Krasniqi, Nysret, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99-AIKD, Prishtinë, 2016.

Lodge David, *The Art of Fiction*, Viking Pengiun, New York, 1992.

Shala, Rexhep M., METATEZA, *Teoria dhe praksisi letrar*, Neokultura, Prishtinë, 2014.

Shala, Rexhep M., *Theory, komunikimi modern*, Papyrus, Prishtinë, 2001.

Veprat:

Musa Ramadani, *Antiprocioni*, Buzuku, Prishtinë, 2015.

Musa Ramadani, *Fluroma*, Rilindja, Prishtinë, 1978.

Musa Ramadani, *Inamor:55*, Buzuku, Prishtinë, 2000.

Musa Ramadani, *Ligatina*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

Musa Ramadani, *Romani pa kornizë*, Bota e re, Prishtinë, 1975.

Musa Ramadani, *Satana ma vodhi gurin e urtisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2007.

Musa Ramadani, *Vrapuesja e Prizrenit*, Faik Konica, Prishtinë, 2005.

Musa Ramadani, *Zezone*, Rilindja, Prishtinë, 1978.